



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:115490
Datë: 08.08.2024
Numri i dokumentit: 06030670

K.DH.Shk II.nr.815/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, në Prishtinë kundër debitorit “MAB” Project shpk me NUI:810549157 me seli ne Fushe Kosove, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1317/23 të datës 26.09.2023, me datë **07.08.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës **ANULOHET** aktvendimi Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1317/23 të datës 26.09.2023 dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale –Dhomës se Shkalles se Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1317/23 të datës 26.09.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e d debitorit “MAB” Project shpk me seli ne Fushe Kosove dhe ka shfuqizuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.76/23 i datës 23.02.2023 i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1317/23 të datës 26.09.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Prishtinës, me datën 22.02.2023, ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë të Aktvendimit 05 Nr.351/02-109035/19 i datës 29.08.2019, për te cilin pretendon se është i formës se prere dhe i ekzekutueshëm qe nga data 29.08.2019, duke propozuar qe te detyrohet debitori qe ne afat prej 7 ditësh t'i paguajnë obligimet pa paguara ne shume prej 31,409.30 euro si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore. Duke vendosur sipas propozimit te kreditorit, përmbartuesi privat Destan Bujupaj, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.76/23, te datës 23.02.2023, me te cilin ka lejuar përmbartimin, si ne propozimin e kreditorit.

Kundër urdhrin përmbartimor në afatin e paraparë ligjor prapësim ka ushtruar debitori, duke deklaruar se debitori, ka përmbushur një pjese te detyrimit, siç është detyruara ne bazë të Aktvendimit 05 Nr.351/02-109035/19 i datës 29.08.2019, mirëpo me shfaqjen e pandemisë Covid 19, ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e lejes se ndërtimit, e njëjta kërkesë është refuzuar, e qe nënkupton se dokumenti është shfuqizuar, pra i njëjti është pa efekt juridik. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar Gjykatës ta aprovoj si të bazuar prapësimin, anulohet urdhri përmbartimor si dhe të detyrohet kreditori që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim përmes të cilës i kundërshton pretendimet e debitorit se dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbartimi nuk ka titull ekzekutiv, duke theksuar se nga provat te cilat gjendjen ne shkresa te lendes vërtetohet fakti i formës se prere dhe përmbartueshmerise, pra dokumenti është i rregullt. Andaj i ka propozuar Gjykatës ta refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorëve, vazhdohet procedura përmbartimore dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1317/23 të datës 26.09.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit "MAB" Project shpk me NUI:810549157 me seli ne Fushe Kosove dhe ka shfuqizuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.2512/20 i datës 30.09.2020 i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj..

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se dokumenti përmbartimor, ne rastin konkret nuk përben bazën juridike për caktimin e përmbartimit, pasi qe nuk paraqet titull

ekzekutiv sipas nenit 21 te LPP-se, pasi qe nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe permbarueshmerise siç kërkohet ne kuptim te nenit 36 par.1 te LPP-se.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të dokumentit, ne te cilin është shënuar – konstatuar fakti se dokumenti përmbartimor, në bazë të të cilit është lejuar përmbartimi Aktvendimi 05 Nr.351/02-109035/19 i datës 29.08.2019, është i formës se prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 29.08.2019.

Duke pas parasysh kete paqartësi, te cilën e ka pas gjykata e shkalles se pare, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkalles se parë duhet të këtë parasysh nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili thotë, se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimin. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik.*

Gjykata e shkallës së parë udhëzohet që në ri procedurë të bëjë eliminimin e shkeljeve konform te gjeturave nga gjykata e shkallës se dytë, ashtu që të shqyrtoj dhe analizoj drejtë shkresat ne lendë dhe eventualisht duke caktuar seancë dëgjimore ne kuptim të dispozitave të lartcekura, në mënyrë që të ftohen palët ndërgjyqëse në seancë, të njëjtat të deklarohen rreth kësaj çështje, me qellim te eliminimit te kësaj dileme, se dokumenti përmbartimor a përmban klauzolën e permbarueshmerise dhe plotfuqishmërisë, më pastaj duke vlerësuar edhe shkaqet ligjore nga neni 71 të LPP-së, te vendos sipas dispozitave ligjore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.Shk.II.nr.815/24 me datë 07.08.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami d.v.